

## V E N D I M

### PER RREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Sot me date 21.02. 2000, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Jurilda Cops, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesve **Zoti Sokol SALATI, Gjergji SALATI e Luan SHEHU** te cilet me kerkuan rregjistrimin e Shoqerise Tregtare "SALATI" Sh.a. si Person Juridik Privat,

### K O N S T A T O V A :

Kerkuesit **Zoti Sokol SALATI, Gjergji SALATI e Luan SHEHU**, shtetas shqiptare, kerkojne te rregjistrojne Shoqerine Tregtare "SALATI" Sh.a. me seli ne qytetin e Vlores, me adrese Rruga "Petrit Bifsha" Pallati 11 katesh, shk.2, Ap.1, me objekt te veprimtarise si me poshte :

Ushtrimin e veprimtarise se tregetimit me shumice te naftes bruto, gazit dhe nenprodukteve te tyre.

Kryerjen e veprimtarise ne fushen e servisit te te gjitha llojeve te makinave duke perfshire ketu edhe tregetimin me shumice e pakice te pjeseve te kembimit me synim realizimin e ketij qellimi, por edhe me qellim tregetimi.

Tregetimi me shumice e pakice i mallrave industriale, ushqimore, elektrike, elektroshtepiake, produkteve bujqesore, konfeksione, pjese kembimi, etj.

Pjesmarrja ne tendera, ankande te organizuara nga persona fizike dhe juridike ose nga institucionet shtetore si ne fushen e aktivitetit te shprehur me siper ashtu edhe ne fusha ne tjera.

Shoqeria per arritjen e objektit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme, duke perfshire edhe blerjen e aksioneve edhe ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete ne vleren 2 000 000 (dy milion) leke. Ortaket e Shoqerise jane : **Zoti Sokol SALATI, Gjergji SALATI e Luan SHEHU**, secili me **33.33 %** te kuotave te kapitalit themeltar. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar. Administrator i shoqerise do te jete **zoti Sokol SALATI**, njekohesisht edhe me cilesine e Ortakut.

Per sa me siper kerkesa e bere prej tyre eshte plotesisht e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

### PER KETO ARSYE:

Ne baze te ligjit nr.7638 date 10.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" e ligjit nr.7667 date 28.01.1993 "Per Rregjistrin Tregtar",

### VENDOSA:

Te rregjistroj si Person Juridik Privat Shoqerine Tregtare "SALATI" Sh.a. me seli ne qytetin e Vlores, me adrese Lagjia "Rilindja", Rruga "Petrit Bifsha", me ortake Themelues **Zotin Sokol SALATI, Gjergji SALATI e Luan SHEHU, me nga 33.33 %** te kuotave ne kapitalin themeltar dhe Administrator **Zotin Sokol SALATI** dhe me kapital themeltar 2 000 000 (dy milion) leke, me kohezgjatje me afat kohor te pakufizuar dhe me objekt :

Ushtrimin e veprimtarise se tregtimit me shumice te naftes bruto, gazit dhe nenprodukteve te tyre.

Kryerjen e veprimtarise ne fushen e servisit te te gjitha llojeve te makinave duke perfshire ketu edhe tregtimin me shumice e pakice te pjeseve te kembimit me synim realizimin e ketij qellimi, por edhe me qellim tregtimi.


Tregtimi me shumice e pakice i mallrave industriale, ushqimore, elektrike, elektroshtepiake, produktev bujqesore, konfeksione, pjese kembimi, etj.

Pjesmarrja ne tendera, ankande te organizuara nga persona fizike dhe juridike ose nga institucionet shteterore si ne fushen e aktivitetit te shprehur me siper ashtu edhe ne fusha te tjera.

Shoqeria per arritjen e objektit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme, duke perfshire edhe blerjen e aksioneve edhe ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.


Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE

*Enilda Cop*  


23.10.14 Luella Regi Shua

- Executive - SALATI sh.a.
- Kapital - 2.000.000 leker
- Seluar - More, Ri. P. B/Sha.
- Aknener - Sokel, Seloti, Gepp.  
Seloti, duou slelu  
syeni 33.33%
- Statuti - 22/11/14
- Akt. Haudant - 11/11/14
- St Regi Shua - 21/02/2005
- 

Y. M. S.  
A. Sopo  


**KONTRATE THEMELIMI  
E  
SHOQERISE ANONIME "SALATI" SH.A**



Me cilesine e aksionereve themelues, Zoti Sokol Salati, i biri i Tekiut, i datelindjes 1962, lindur e banues ne Vlore, Zoti Gjergji Salati, i biri i Tekiut, i datelindjes 1966, lindur e banues ne Vlore si dhe Zoti Luan Shehu, i biri Bajazit i datelindjes 1962 si bashkethemelues te Shoqerise Anonime "SALATI" Sh.a, kane vendosur sa me poshte:

**NENI 1**

Te themelojne Shoqerine Tregtare "SALATI" Sh.a. ne formen e nje shoqerie anonime pa oferte publike me emrin "SALATI" Sh.a. Ne te gjitha aktet qe do te nxjerre shoqeria kundrejtuar te treteve si dhe ne gjitha aktet e brendshme te saj, do te shenohet detyrimisht emri "SALATI" Sh.a.

**NENI 2**

**Objekt i veprimtarise se kesaj shoqerie do te jete :**

Ushtrimi i veprimtarise se tregtimit me shumice te naftes bruto, gazit dhe nenprodukteve te tyre.

Kryerjen e veprimtrise ne fushen e servisit te te gjitha llojeve te makinave duke perfshire ketu edhe tregtimin me shumice dhe pakice te pjeseve te kembimit me synim realizimin e ketij qellimi, por edhe per qellim tregtimi.

Tregetimi me shumice dhe pakice i mallrave industriale, ushqimore, elektrike, elektroshtepiake produkteve bujqesore, konfeksione, pjese kembimi etj.

Prodhimi dhe tregetimi i materialeve te ndertimit, import - eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve.

Pjesmarrja ne tendera, ankande te organizuara nga persona fizike dhe juridike ose nga institucionet shteterore si ne fushen e aktivitetit te shprehur si me siper ashtu edhe ne fusha te tjera.

Shoqeria per arritjen e qellimit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme duke perfshire edhe blerjen e aksioneve ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

### **NENI 3**

Selia e Shoqerise do te jete ne Qytetin e Vlores, lagja "RILINDJA", Rr. "Petrit Bifsha" Pall 11 katesh, shk.2 Ap.1.

### **NENI 4**

Kapitali themeltar i shoqerise do te jete i perbere nga kontributet ne te holla te aksionereve themelues te kesaj Shoqerie.

Kontributi ne para do te jete i perbere nga shuma prej 2.000.000 leke, qe eshte edhe vlera minimale e kapitalit themeltar per shoqerite pa oferte publike, shume e derdhur teresisht ne momentin e nenshkrimtit te kesaj kontrate themelimi nga bashkeaksioneret themelues te kesaj Shoqerie.

### **NENI 5**

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 2000 aksione me vlere nominale prej 1000 leke .

Sejcili prej aksionereve themelues do te zoteroje ne menyre te barabarte vleren pre 33.33 % te shumes se kapitalit themeltar te shoqerise.

### **NENI 6**

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e Aksionereve, e cila perfaqesohet nga aksioneret themelues te cilet perfaqesojne ne menyre te barabarte nga 33.33 % te vleres se kapitalit themeltar te shoqerise.

### **NENI 7**

Drejtoria e Shoqerise perbehet nga nje antar i vetem.

Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej tre vjetesh.

Drejtor i Shoqerise do te jete zoti Sokol Salati.

Drejtori i Shoqerise zgjidhet nga Keshilli Mbikqyres, per perudhen kohore te shprehur si me siper.



### **NENI 8**

Keshilli Mbikqyres i shoqerise perbehet nga tre antare, te cilet jane caktuar si me poshte:



1. Gjegji Salati.
2. Luan Shehu.
3. Sokrat Dauti.

Kohezgjatja e antareve te Keshillit Mbikeqyres do te jete jo me shume se tre vjet.

### **NENI 9**

Ekspert kontabel te autorizuar te shoqerise do te emerohen ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe per cdo vit financiar te ushtrimit te veprimtarise se shoqerise. Ekspertet e pare 1 vjecare jane:

1. Gezim Lila
2. Namik Veipi

### **NENI 10.**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqerise, ngritja e degeve apo filialeve te saj, do te behet ne perputhje me dispozitat e statutit.

## **AKSIONERET THEMELUES**

**SOKOL SALATI**

Sokol Salati

**GJERGJI SALATI**

Gjegji Salati

**LUAN SHEHU**

Luan Shehu



**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ANONIME**  
**"SALATI" SH.A**

**KAPITULLI I**  
**Forma ligjore, emertimi, selia e shoqerise.**

**Neni 1**  
**Forma juridike**

Ne mbeshtetje te vullnetit te aksionereve themelues te shprehur ne kontraten e themelimit midis bashkeaksionereve, Zotit Sokol Salati, Zotit Gjergji Salati dhe Zotit Luan Shehu si dhe ne pajtim te plote me dispozitat e Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" themelohet Shoqeria Tregtare "SALATI" Sh.a. e cila do te funksionojë sipas dispozitave te kontrates se themelit dhe ketij statuti.

**Neni 2**  
**Shoqeria ka per objekt veprimtarie te saj :**

Ushtrimi i veprimtarise se tregtimit me shumice te naftes bruto, gazit dhe nenprodukteve te tyre.

Kryerjen e veprimtarise ne fushen e servisit te te gjitha llojeve te makinave duke perfshire ketu edhe tregtimin me shumice e pakice te pjeseve te kembimit me synim realizimin e ketij qellimi, por edhe me qellim tregetimi.

Tregetimi me shumice dhe pakice i mallrave industriale, ushqimore, elektrike, elektroshtepiake, produkteve bujqesore, konfeksione, pjese kembimi etj.

Prodhimi dhe tregetimi i materialeve te ndertimit, import - eksporti i tyre brenda dhe jashte vendit per llogari te vete shoqerise si dhe te treteve.

Pjesmarrja ne tendera, ankande te organizuara nga persona fizike dhe juridike ose nga institucionet shteterore si ne fushen e aktivitetit te shprehur si me siper ashtu edhe ne fusha te tjera.

Pjesmarrja ne tendera, ankande te organizuara nga persona fizike dhe juridike ose nga institucionet shteterore si ne fushen e aktivitetit te shprehur si me siper ashtu edhe ne fusha te tjera.



Shoqeria per arritjen e qellimit te saj, kryen cdo lloj veprimtarie te dobishme duke perfshire edhe blerjen e aksioneve eshe ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

### **Neni 3** **Emertimi**

Emertimi i plote i shoqerise eshte "SALATI" Sh.a. Shoqeria ka stemen dhe vulen e saj.

### **Neni 4** **Selia, Deget, Agjencite dhe Zyrat e Perfaqesimit**

Selia e shoqerise eshte ne Vlore ku do te ndodhet edhe Drejtoria e saj, me adrese : lagjia "RILINDJA", Rruga "Petrit Bifsha".

Veprimtaria e shoqerise ne tere territorin e Republikes se Shqiperise kryhet nga deget dhe agjencite e saj, te cilat funksionojne ne rrethe apo ndarje te tjera administrative te Republikes se Shqiperise nen drejtimin e Drejtorise.

Shoqeria mund te cele dege, agjensi dhe zyra perfaqesimi te reja jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ato celen dhe prishen me vendim te Keshillit Mbikqyres.

## **KAPITULLI II**

### **KAPITALI THEMELTAR AKSIONET NDRYSHIMET E KAPITALIT**

### **Neni 5** **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 2 000 000 leke.



Ai është i ndare, në 2 000 aksione të së njëjtes kategori me vlerë nominale prej 1 000 leke, për çdo aksion të shlyer për teresinë e vlerës nominale të tyre.



Aksionet janë të numëtuara nga 1 deri 2000 aksione.

## **Neni 6**

### **Forma e aksioneve**

Aksionet e Shoqërisë janë nominative.

Pronesia e aksioneve vërtetohet nga regjistrimi i tyre në emër të pronarit në regjistrin e mbajtur për këtë qëllim nga Shoqëria, sipas mënyrës të parashikuar me ligj. Me kërkesën e aksionerit, Shoqëria i leshon atij një vërtetim të regjistrimit të aksioneve në pronësi të tij.

Aksionet janë të pandashme. Bashkëpronaret e aksioneve përfaqësohen në shoqëri nga njëri prej tyre, i cili konsiderohet si pronar i vetëm i zgjedhur nga pronaret. Në rast mosmarrëveshjeje, përfaqësuesi caktohet nga gjykata me kërkesën e bashkëpronarit që e merr i pari këtë nismë.

## **Neni 7**

### **Shitja dhe transferimi i aksioneve**

Përveç rastit të trashëgimit, transferimi i pronësive mbi aksionet e një të treti, pavarësisht nga baza juridike e këtij transferimi, duhet të miratohet nga Këshilli Mbikqyres në kushtet dhe sipas procedurave të parashikuara në nenin 207 të ligjit "Për Shoqëritë Tregtare".

Në qoftë se Këshilli Mbikqyres ka refuzuar shitjen e aksioneve një blerësi jashtë bashkësisë së aksionereve, shitesit duhet të njoftojë shoqërinë me leter rekomandë brenda 8 ditëve nga data e njoftimit të realizimit, nëse ka hequr dorë nga projekti i shitjeve të aksioneve. Në rast se shitesit nuk ka hequr dorë nga ky projekt, Këshilli Mbikqyres duhet të sigurojë blerjen e aksioneve prej një ose disa persona të zgjedhur prej tij.

Neqoftëse, për vlerësimin e aksioneve nevojitet një akt ekspertimi shpenzimet e ekspertit paguhen përgjysem të ndara midis shitesit dhe blerësit.



## **Neni 8**

### **Zmadhimi i kapitalit themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise mund te zmadhohet sipas menyrave dhe rregullave te parashikuara ne nenet 150 deri 163 te lggjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem me, Vendim te Asamblese te Jashtezakonshme te aksionereve, ne baze te raportit te Drejtorise, te hartuar ne menyren e kerkuar nga ligji.

Aksioneret kane te drejten e perparise per nenshkrimin e aksioneve te shlyeshme ne para qe emetohen per zmadhimin e kapitalit. Kjo e drejte eshte ne perpjestim me shumen e aksioneve te zoteruara nga sejcili aksioner perpara zmadhimit te kapitalit.

Aksioneret mund te heqin dore vetem individualisht nga e drejta per nenshkrimin e aksioneve te reja. Ata, gjithashtu, kane te drejte te, kerkojne nenshkrimin e nje numri me te vogel aksionesh nga sa u takon sipas parimit te perpjestueshmerise, por me kusht qe Asambleja te kete vendosur shprehimisht per kete gje.

## **Neni 9**


### **Shlyerja e aksioneve**

Aksionet per kapitalin ne para te nenshkruara ne zbatim te nje vendimi per zmadhimin e kapitalit do te shlyhen per 100 perqind te vleres se tyre qysh ne castin e nenshkrimimit.

Pjesa tjeter e vleres do te shlyhet me keste, ne baze te kerkimit per shlyerje nga Keshilli Mbikqyres brenda nje afati 3 vjet nga data kur zmadhimi i kapitalit eshte kryer perfundimisht.

Asambleja e Pergjitheshme e Jashtezakonshme qe vendos zmadhimin e kapitalit, ka te drejte te marre vendimin per shlyerjen teresore te aksioneve qysh ne castin e nenshkrimimit ose brenda nje afati me te shkurter, nga ai i permendur ne paragrafin e dyte te ketij neni.

Kerkimi i fondeve u njoftohet nenshkruesve te pakten 15 dite perpara dates se caktuar per cdo derdhje, me leter rekomande dhe me kthim pergjigje, drejtuar cdo pronari te aksioneve.



Cdo vonese ne derdhien e shumave te kerkuara sjell pagimin e interesave sipas perqindjeve te caktuara me ligj, duke filluar nga data e kerkimit te cdo derdhjeje pa qene nevoja per te proceduar ne formalitete te tjera te c'faredoshme dhe pa hequr dore nga veprimet e Shoqerise ndaj aksionerit detyrues dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara, nga ligji.

## **Neni 10**

### **Zvogelimi i kapitalit themeltar**

Zvogelimi i kapitalit themeltar te shoqerise kryhet vetem me Vendim te Asamblese te Pergjithshme te Jashtezakonshme te aksionereve dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 164 deri 166 te, ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare". Zvogelimi i kapitalit themeltar nuk duhet te cenoje raportet e aksionereve para ketij zvogelimi.

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen shumen minimale te kerkuar nga ligji.

## **Neni 11**

### **Te drejtat dhe detyrimet e lidhura me aksionet.**

Cdo aksioner jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet vjetore te shoqerise te destinuara per shperndarje dhe ne tepricen e aktivitetit te mbetur ne rastin e likuidimit, ne perpjestim me aksionet qe zoteron.

Pronesia mbi aksionet jep edhe te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne mbledhjet e asamblese se pergjitheshme ne kushtet e percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Aksioneret pergjigjen per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te aksioneve qe zoterojne. Ndalohet kerkimi i fondeve te kesaj shume.

Kur aksionet u kalojne aksionereve te rinj, keta ruajne te drejtat e detyrimeve qe vijne nga aksionet.



Pronesia e nje aksioni permban automatikisht te drejten e aderimit ne statutin e shoqerise dhe ne vendimet e asamblese se pergjithshme.

## KAPITULLI III

### DREJTIMI I SHOQERISE

#### Seksioni I Drejtoria

#### **Neni 12** **Perberja dhe emerimi**

Drejtimi i pergjithshem i shoqerise kryhet nga Drejtoria, e cila per Shoqerine "SALATI" Sh.a. do te perbehet nga nje antare, detyrimisht person fizike.

Drejtori emerohet dhe shkarkohen nga Keshilli Mbikqyres.

Drejtor i Shoqerise Tregtare "SALATI" Sh.a. do te jete aksioneri themelues zoti Sokol Salati.

Drejtori i ushtron funksionet e tij nen kontrollin e Keshillit Mbikqyres.

#### **Neni 13** **Kohezgjatja e funksioneve te Drejtorise.**

Anetaret e Drejtorise emerohet per the periudhe prej tre vjetesh. Anetaret e saj jane te rizgjedhshem. Ata mund te shkarkohen nga detyra e tyre me vendim te Keshillit Mbikqyres per shkaqe te perligjura.

Antari i Drejtorise mund ta mbaje kete funksion deri ne moshen 65 vjec. Megjithete anetari i drejtorise qe ka mbushur kete moshe i ruan funksionet e tij deri ne mbledhjen e afert te Asamblese se Pergjithshme te thirrur per te vendosur mbi llogarite vjetore te ushtrimit financiar te mbyllur.

Ne qofte se vendi i drejtorit mbetet bosh, zevendesimi i tij behet nga Keshilli Mbikeqyres. Anetari zevendesues emerohet per

periudhen qe mbetet deri ne emerimin pasardhes te antarit tjetër te drejtorise.



#### **Neni 14** **Shkarkimi i Anetareve te Drejtorise**

Anetaret e Drejtorise mund te shkarkohen gjate mandatit te tyre kur:

1. Jane shpallur fajtores me vendim te formes se prere te gjykates per kryerjen e nje vepre penale qe ka lidhje me veprimtarine ekonomiko-financiare.
2. Jane vertetuar se kane shperdoruar fondet e shoqerise.
3. Jane raste te parashikuara ne nenin 98 te Ligjit Nr.7638, date 19. 11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare".

#### **Neni 15** **Funksionimi i Drejtorise**


Dreitoria si rregull funksion si organ kolegjal. Keshilli Mbikqyres mund te vendose qe antaret e drejtorise te ndajne detyra te caktuara per drejtimin sa me te zhdervjellte te shoqerise. Pavaresisht nga ndarja e detyrave, aktet individuale te cdo anetari te drejtorise konsiderohen te kryera kolegjalisht. Antaret e Drejtorise qe u jane caktuar detyra te vecanta duhet te informojne periodikisht drejtorine per vendimet qe kane marre.

Keshilli Mbikqyres mund te percaktoje ceshtjet per te cilat antaret e drejtorise duhet te marrin vendime bashkarisht.

Anetaret e Drejtorise ne zbatim te urdherave te Drejtorise ose te Keshillit Mbikqyres, mund te nxjerrin akte individualisht, per sektorin te cilin ata mbulojne.

#### **Neni 16** **Perfaqesimi i shoqerise**

Shoqeria perfaqesohet nga Drejtori i i saj ose i autorizuari i tij para te gjithë institucioneve publike e private, organeve gjyqesore si dhe ne marredheniet me te tretet.



## **Neni 17**

### **Mbledhjet e drejtorise dhe vendimet**

Mbledhja e drejtorise drejtohet nga Drejtori i saj ose personi i autorizuar rregullisht prej tij.

Mbledhjet e drejtorise zhvillohen, si rregull, ne seline e shoqerise. Ato drejtohen nga Drejtori i saj qe kryen edhe procedurat e nevojeshme per thirrjen e mbledhjes.

Vendimet merren me shumice votash.

Ne qofte se ne mbledhje jane te pranishem vetem dy anetare te drejtorise vendimi duhet te merren me unanimitet.

## **Neni 18**

### **Kompetencat e Drejtorise**

Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise ne cdo rethane. Ajo i ushtron keto kompetenca brenda kufijve te objektit te shoqerise, dhe kufizohet nga ato kompetenca qe ligji ua jep shprehimisht Keshillit Mbikqyres dhe Asambleve te Aksionereve.

## **Neni 19**

### **Operacione te autorizuar**

Drejtoria kerkon autorizim paraprak nga Keshilli Mbikqyres per :

- a. krijimin e garancive me ane te pasurise se shoqerise.
- b. kryerja e investimeve qe nuk perfshihen ne programin financiar vjetor.
- c. celjen e veprimtarive ose degeve e agjencive te reja;
- c. shkrirja, bashkimi dhe mbyllja teresisht ose pjeserisht e veprimtarive dhe degeve te shoqerise.
- d. pesemarrja ne shoqeri te tjera.
- e. shitja dhe shkembimi i pasurive qe perbejne aktive te qendrueshme te shoqerise.
- f. lidhjen ose ndryshimin e kontratave qe kapercejne vleren e caktuar nga

Keshilli Mbikqyres.

Kur Keshilli Mbikqyres refuzon te jape autorizimin e kerkuar, Drejtoria mund t'i kerkoje aksionereve te urdherojne Keshillin Mbikqyres te leshojne autorizimin ose ta autorizojne vete.



## **Neni 20**

### **Shperblimi i Anetareve te Drejtorise**


Masa e shperblimit e antareve te drejtorise caktohet nga Asambleja ne aktin e emerimit.

## **Neni 21**

### **Pergjegesia e Anetareve te Drejtorise**

Anetaret e drejtorise jane pergjegjes, civilisht dhe penalisht per aktet e drejtimit te tyre, ne pajtim me dispozitat e legjislacionit ne fuqi.

**Seksioni 2**  
**Keshilli Mbikqyres**



**Neni 22**  
**Perberja dhe emerimi**

Keshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres emrohen nga Asambleja e Aksionereve dhe nuk kane statusin e te punesuarit ne shoqeri.

**Neni 23**  
**Person Juridik anetar i keshillit te mbikqyres**

Nje person juridik qe eshte aksioner i shoqerise nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres. Ne kete rast ky duhet te caktoje, qysh ne castin e zgjedhjes, nje perfaqesues te perhereshem person fizik, i cili u nenshtrohet te njejtave kushte dhe detyrimeve dhe ka te njejta pergjegjesi civile e penale si te ishte ai vete anetar i Keshillit, duke mos perjashtuar nga pergjegjesia e perbashket edhe personin juridik qe ai perfaqeson.


Ne qofte se personi juridik i revokon mandatin perfaqesuesit te tij, ai duhet te njoftoje per kete shoqerine pa vonese dhe te beje zevendesimin e tij. Ky rregull do te zbatohet edhe ne rastet e vdekjes, te doreheqies ose te pengimeve te zgjatura te perfaqesuesit te perhershem.

**Neni 24**  
**Kohezgjatja e funksioneve dhe vendet bosh**

Kohezgjatja e funksioneve te anetareve te Keshillit Mbikqyres eshte tre vjet por s'duhet te kaloje 6 vjet. Nje vit eshte periudha midis dy mbledhjeve vjetore te Asamblese te Pergjitheshme.



Ne qofte se nje ose disa vende te anetareve te Keshillit Mbiqyres te zgjedhur nga asambleja mbeten bosh per shkak te vdekjes, doreheqies ose nje pengimi per nje kohe te gjate, Keshilli njofton asmlene e aksionereve, te cilet bejne zevendesimet perkatese.



## **Neni 25**

### **Kryetari dhe Zevendeskryetari i Keshillit Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres, nga perberja e tij ka nje kryetar dhe nje zevendeskryetar qe ngarkohen me organizimin dhe zhvillimin e mbledhjeve te Keshillit.

Kryetari dhe Zevendeskryetari i Keshillit Mbikqyres jane persona fizike dhe nuk mund te zgjidhen ndermjet perfaqesuesve te personave juridike apo anetareve te zgjedhur nga te punesuarit e shoqerise.

Ata ushtrojne funksionet e tyre gjate tere periudhes se mandatit te dhene.

Kryetari dhe zevendeskryetari i Keshillit Mbikqyres mund te rizgjidhen.

Keshilli Mbikqyres mund te emerroje nje sekretar te zgjedhur midis anetareve te keshillit ose jashte tyre duke caktuar edhe kohezgjatjen e funksioneve te ketij.

## **Neni 26**


### **Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres. Quorumi**

Keshilli Mbikqyres mblidhet me thirrjen e kryetarit, ose ne rast pengimi te ketij, te zevendeskryetarit, sa here qe e kerkon interesi i shoqerise dhe sa here shtrohen ceshtje per tu zgjedhur dhe qe jane ne kompetence te ketij Keshilli. Ne cdo rast Keshilli duhet te mblidhet detyrimisht nje here ne tre muaj.

Thirrja e keshillit behet me cdo lloj menyre.

Kryetari i Keshillit Mbikqyres, duhet te therrase mbledhjen e Keshillit brenda 15 ditesh kur te pakten nje anetar i Drejtorise ose nje e treta e anetareve te Keshillit Mbikqyres i paraqit nje kerkese te motivuar per

kete. Ne qofte se kerkesa nuk merr pergjigje, kerkuesit mund te procedojne vete me thirrjen e mbledhjes te Keshillit Mbikqyres, duke treguar rendin e dites te mbledhjes.



Mbledhjet e Keshillit Mbikqyres mbahen ne seline, e shoqerise.

Rendi i dites vendoset nga kryetari ose, ne mungese te tij nga zevendes kryetari, ose nga anetari i drejtorise apo anetaret e Keshillit Mbikqyres qe kane kerkuar thirrjen e mbledhjes.

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres mund t'i jape mandat nje anetari tjetër per ta perfaqesuar ne nje seance te Keshillit. Cdo anetar mund te jape vetem nje mandat per te njejten seance.

Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres jane te vlefshme kur numri, i anetareve te pranishem, ne mbledhje eshte te pakten sa gjysma e anetareve ne funksion.

Vendimet merren me shumicen e votave te anetareve te pranishem dhe te perfaqesuar.

Ne rast votash te barabarta ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Ne seline e shoqerise mbahet nje regjister i pranise, i cili firmoset nga anetaret e keshillit pjesemarrës ne seance.


Shqyrtimet dhe vendimet e Keshillit Mbikqyres evidencohen me procesverbale te hartuara ne nje regjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, qe mbahet ne seline e shoqerise, ne te cilin tregohen anetaret e pranishem, te perfaqesuar dhe qe mungojne si dhe cdo person qe ka asistuar ne mbledhje, teresisht apo pjeserisht.

Proces verbalet firmosen nga te gjithë anetaret e pranishem,

## **Neni 27**

### **Kompetencat e Keshillit Mbikqyres**

Keshilli Mbikqyres ushtron mbikqyrje ne menyre te perhershme ne drejtimin dhe administrimin e shoqerise nga ana e Drejtorise. Ai vendos



per operacionet qe duhet te kryhen me autorizim te tij ne baze te nenit 19 te ketij statuti.

Keshilli mbikqyres miraton programet vjetore te zhvillimit te shoqerise si dhe planin e saj ekonomiko-financiar dhe ia paraqet per miratim, perfundimisht Asamblese se aksionereve.

Keshilli Mbikqyres miraton strukturen organizative te shoqerise dhe ndryshimet e saj, kriteret e punesimit dhe te pagave si dhe rregulloren e brendshme te shoqerise.

Ne cdo kohe te vitit, Keshilli Mbikqyres kryhen te gjitha verifikimet dhe kontrollet qe ai i cmon te arsyeshme dhe ka te drejte te kerkoje te njihet me dokumentet qe ai gjykon te nevojshme per permbushjen e funksioneve te tij. Nje here ne tre muaj ai merr nje raport te paraqitur nga Drejtoria.

Brenda tre muajve nga mbyllja e cdo viti financiar Drejtoria i paraqit atij me qellim verifikimi e kontrolli, llogarite vjetore si dhe nje raport te shkruar per gjendjen e shoqerise dhe aktivitetet e saj gjate vitit financiar te mbyllur.

## **Neni 28**


### **E drejta per informim e anetareve te keshillit**

Cdo anetar i Keshillit Mbikqyres ka te drejte te kerkoje dhe te marre nga Drejtoria informacion per ceshtje te natyres administrative, teknike dhe financiare qe i mundesojne atij te verifikojte dhe gjykoje per kushtet ne te cilat zhvillohet veprimtaria e shoqerise dhe te jete plotesisht i qarte per vendimet qe duhen marre apo qe do te merren nga ana e keshillit.

Kryetari i keshillit ka pergjegjesine per t'i vene anetaret e Keshillit ne gjendje qe te, marrin informacionet e kerkuara.

Cdo anetar i Keshillit duhet te njoftohet personalisht per mbledhjet e Keshillit dhe t'i vihen ne dispozicion ne seline e shoqerise apo t'i dergohen bashke me thirrjen dokumentet dhe raportet qe do te shqyrtohen ne mbledhje.

Shoqeria nuk eshte e detyruar t'i jape anetareve te Keshillit drejtues kopjo te proces verbaleve te vendimeve te keshillit, por cdo anetar mund te kerkoje qe te njihet me to ne seline e shoqerise.



Mosnjohja e te drejtave te cdo anetari te Keshillit per informacionet e mesiperme dhe mos thirrja ne mbledhjen e keshillit sjell paviefshmerine e vendimeve te Keshillit.

### **Neni 29**

#### **Shperblimi per anetaresine ne keshill dhe shperblimet e jashtezakonshme**

Asambleja e Pergjithshme e zakonshme mund t'u caktoj anetareve te Keshillit Mbikqyres si shperblim per pjesemarrjen ne keshill nje shume vjetore fikse, e cila mbetet e pandryshuar deri ne nje vendim te kundert te asamblese.

Keshilli Mbikqyres mund te caktoj shperblime te jashtezakonshme per anetaret te cileve u ngarkohen sherbime apo detyra te caktuara. Shperblimet e jashtezakonshme i nenshtrohen miratimit nga Asambleja e Pergjithshme e zakonshme sipas rregullave te parashikuara nga nenet 122 deri 125 te ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

Shperblimet e vecanta dhe te jashtezakonshme perballohen nga llogaria e shoqerise dhe kalohen ne shpenzimet e saj.

Pervec shperblimeve te permendura ne kete nen, anetareve te Keshillit nuk u caktohet asnje shperblim tjeter i perhershem ose jo.

### **Seksioni 3**

#### **DISPOZITA TE PERBASHKETA PER ANETARET E DREJTORISE DHE ANETARET E KESHILLIT MBIKQYRES**

### **Neni 30**

#### **Marreveshiet qe kerkojne autorizim**

Cdo marreveshie ndermjet shoqenise dhe nje nga anetaret e drejtorise ose te Keshillit Mbikqyres, qe lidhet drejtperdrejte, apo me te cilen nje nga

personat e sipërpermendur lidhet indirekt apo nepermjet nje personi ndermjetes te autorizohet paraprakisht nga Keshilli Mbikqyres.



Kryetari i Keshillit Mbikqyres njofton ekspertin kontabel te autorizuar per marreveshjet e autorizuar nje muaj perpara se marreveshja te lidhet dhe i shtron keto marreveshje per miratim Asamblese se Pergjitheshme.

Ekspertet Kontabel te Autorizuar i paraqitin Asamblese nje raport te posacem per keto marreveshje, e cila vendos mbi kete raport.

Dispozitat e mesiperme nuk zbatohen per marreveshjet qe kane te bejne me operacionet rrjedhese dhe te kryera ne kushte normale.

### **Neni 31**

#### **Mareveshjet e ndaluara**


Anetareve te drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres, u ndalohet te kontraktojne qe te marrin hua nga shoqeria, t'u akordohet nga shoqeria nje zbulim me llogari rrjedhese ose ne nje forme, tjeter, si dhe te bejne shoqerine dorezenese apo garante per detyrimet e tyre ndaj te treteve. Kjo dispozite nuk zbatohet ne rastin kur keta persona kontraktojne me shoqerine per marrjen e tyre ne sigurim apo per marrjen e veprimtarive dhe mallrave qe lidhen me keto veprimtari ne sigurim ose qe lidhem direkt me karkaterine tyre diagnostikues dhe kurues.

Ky ndalim zbatohet per perfaqesuesit e perhershem te personave juridike anetare te Keshillit Mbikqyres si dhe per bashkeshortet, paraardhesit dhe, pasardhesit e personave te permendur ne kete nen si dhe per c'do person ndermjetes.

### **Neni 32**

#### **Detyrmet per ruajtjen e sekretit**

Anetaret e Drejtorise dhe te Keshillit Mbikqyres si dhe cdo person tjeter qe asiston ne mbledhjet e ketyre, organeve duhet te ruajne fshetesine per ceshtiet dhe te dhenat qe kane karakter te brendeshem



## KAPITULLI IV

### Asambleja e Pergjithshme e Aksionereve

#### **Neni 33**

#### **Mbledhjet e Asamblese dhe efektet detyruese te vendimeve**

Mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve jane te zakoneshme ose te jashtezakoneshme ne vartesi te natyres te ceshtjeve qe diskutohen dhe vendimeve qe do te marre.

Cdo asamble e pergjithshme e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e aksionereve me te drejte vote.

Vendimet e asamblese se pergjithshme detyrojne te gjithe aksioneret madje edhe ata qe mungojne ne mbledhje apo qe votojne kunder.

#### **Neni 34**

#### **Organizimi i mbledhjeve te asamblese**

Asamblete e pergjithshme thirren nga Keshilli Mbikqyres ose nga drejtonia. E drejta per thirrjenen e mbledhjes nga Drejtoria behet mbi bazen e rregullave te funksionimit te saj si organ kolegjal. Mbledhja e Asamblese mund te thirren, gjithashtu, nga Eksperti Kontabel i Autorizuar i pavarur ne raste urgjence, nga nje mandatmbajtes i caktuar nga gjykata dhe kur eshte rasti, nga likuiduesi.

Asamblete e pergjithshme mblidhen ne seline e shoqerise ose ne cdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

Thirrja e asamblese se aksionereve behet me ane te njoftimit qe i dergohet c'do aksioneri ne adresen e tij me leter rekomande.

Njoftimi duhet te bjere ne doren e aksionereve apo te njihet prej tyre 15 dite perpara mbledhies se asamblese dhe duhet te permbaje ditën, orën dhe velidin e mbledhjes, natyrën e asamblese, dhe rendin e dites.



Kur asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar quorumi i kerkuar, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejta forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes te mbledhjes se dyte rikujtojne datën dhe rendin e dites.

### **Neni 35** **Rendi i dites**

Rendi i dites se mbledhjes se asamblese percaktohet nga autori i thirrjes. Nje ose disa aksionere qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te kapitalit themeltar te shoqerise kane te drejte te kerkojne qe te futen ne rendin e dites nje apo disa projektrezoluta.

Keto projektrezoluta dergohen ne seline e shoqerise te shoqeruara me nje kerkese ne te cilen tregohen edhe aresyet, si dhe me nje dokument qe provon zoterimin e pjeses te kapitalit themeltar te kerkuar nga paragrafi i dyte i ketij neni.

Projektrezolutat dhe dokumentet shoqeruese duhet te mberijne ne seline e shoqerise te pakten 5 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese.

Asambleja e aksionereve nuk mund te marre, ne shqyrtini nje geshtje qe nuk eshte perfshire ne rendin e dites. Megjithate ajo mundet, ne cdo rrethane te shkarkoje nje ose disa anetare te Keshillit Mbikqyres dhe te beje zevendesimin e tyre.

### **Neni 36** **Hyrja ne Asamble**

Cdo aksioner, pavaresisht nga numri i aksioneve qe zoteron, ka te drejte te asistojne ne mbledhjet e ambleve te pergjitheshme dhe te marre pjese ne vendimet e saj, personalisht apo neperinjet nje perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjet e asambleve te pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin e aksionerit si dhe te rregjistrimit te tij ne regjistrin e aksioneve te shoqerise.



Cdo aksioner mund te perfaqesohet ne mbledhjet e asamblese vetem nga bashkeshorti ose nga nje aksioner tjetër. Per kete qellim perfaqesuesi duhet te pajiset nga aksioneri me mandat te posacem, ne kushtet e parashikuara nga ligji.

### **Neni 37**

#### **Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces - verbalet.**

Per cdo mbledhje te asamblese mbahet nje flete-pranie e cila permba treguesit qe provojne identitetin e aksionerit dhe aksionet e zoteruara prej tij. Flete-prania firmoset ne ane nga aksioneri ose, kur eshte rasti, nga perfaqesuesi i tij dhe vertetohet per saktesine e saj nga komisioni vezhgues i mbledhjes.

Mbledhjet e asamblese drejtohen nga kryetari i Asamblese. Ne rastet kur thirrj e mbledhjes eshte bere nga Eksperti Kontabel i Autorizuar, mandatmbajtësi i caktuar nga gjykata apo likuiduesi, mbledhja drejtohet nga autori i thirrjes.

Funksionet e vezhgimit te mbledhjes kryhen nga dy aksionere te pranishem te cilet vete ose si perfaqesues, zoterojne nje numer votash me te madh seaksioneret e tjere. Vezhguesit caktojne nje sekretar i cili mund te mos jete aksioner.

Komisioni i vezhgimit, i formuar ne kete menyre, ka per detyre te verifikojë, vertetojë dhe nenshkruaje flete-pranine, te mbikqyre zhvillimin e debateve, te kontrollojë votimet e kryera dhe te sigurojë rregullaritetin e tyre si dhe te mbikqyre mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.

Per c'do mbledhje te asamblese hartohet nje proces verbal i cili permban :

- daten dhe vendin e mbledhjes
- meyren e thirrjes
- rendin e dites
- drejtuesi i mbledhjes dhe komisioni i vezhgimit
- numiri i aksionereve qe marrin pjese ne votim,
- quorumi i arritur
- permendjen e dokumenteve dhe te raporteve qe jane shtruar ne mbledhje
- nje permbledhje te debateve
- tekstet e projektrezolutave te vena ne votim, ato te miratuara dhe ato te



- hedhura poshte nga aksioneret.
- rezultatet e votimeve



Proces verbalet e mbledhjes te asamblese hartohen ne nje rregjister te posacem, i numertuar dhe i vulosur, i cili ruhet ne seline e shoqerise.

### **Neni 38**

#### **Quorumi, votimi, numri i votave**

Ne asamblete e pergjithshme, te zakonshme dhe te jashtezakonshme, quorumi llogantet per teresine e aksioneve qe perbejne kapitalin themeltar te shoqerise

E drejta e votes qe u perket aksioneve eshte perpjestimore me kapitalin qe ato perfaqesojne.

Cdo aksion i kapitalit i jep zoteruesit te drejten e te pakten nje vote. Megjithate kur aksionet e shoqerise zoterohen nga nje ose disa persona juridike ne te cilet shoqeria ka, drejteperdrejte ose terthorazi kontrollin, e drejta e votes te aksioneve te personave juridike nuk mund te jete me shume se 10 per qind te votave qe zoterojne aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar.

Votimi kryhet me doren ngritur, me thirrje emerore ose i fshehte sipas vendimitt te komisionit te vezhgimit dhe drejtuesit te mbledhjes se asamblese.

Votimi kryhet i vecante per c'do ceshtje apo vendim.


### **Neni 39**

#### **Asamblele e pergjitheshme e zakonshme**

Asambleja e pergjithshme e zakonshme mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 6 muave te vitit pasardhes, per te vendosur mbi llogarite e shoqerise per ushtrimin financiar te mbyllur.

Ajo ka nder te tjera, kompetencat qe vijojne:

- te niratoje strategjine e zvellimit afatgjate te shoqerise



- te miratoje plan-biznesin dhe planin financiar vjetor.
- te miratoje, ndryshoje ose te hedhe poshte llogarite vjetore qe jane shtruar per miratim;
- te vendose per shperndarjen dhe destinimin e rezultatin ne pajtim me dispozitat ligjiore dhe me statutin.
- te emeroje dhe shkarkoje anetaret e Keshillit Mblkqyres.
- te shkarkoje me propozim te Keshillit Mbikqyres, anetaret e dretorise. te emeroje Ekspertin ose Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- te miratoje ose te mos miratoje emerimet e anetareve te Keshillit Mblkqyres te kryera nga vete keshilli si emerime te perkohshme.
- te miratoje pagen e drejtorit te saj dhe raportet e pagave per kategorite e tjera te personelit te shoqerise si dhe shperblimet suplementare e mund te jepen per pune ose rezultate te mira.
- te caktoie shperblimin e zkonshem dhe shperblime te tjera te parashikuara ne kete statut per Keshillin Mbikqyres.
- te vendose per raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar lidhur me marreveshjet qe i nenshtrohen autorizimit paraprak te Keshillit Mbikqyres..

Asambleja e zakonshme merr cdo vendim qe nuk sjell ndryshime te statutit. Ajo merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem, kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne jo me pak se 50 per qind te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se mbledhja e pare nuk realizohet per mbledhjen e dyte nuk kerkohej asnje lloj quoriumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.

#### **Neni 40**

#### **Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme.**

Asambleja e prgjithshme e jashtezakonshme mblidhet sa here qe duhet te merret nje vendim qe sjell ndryshime te ketij statuti.

Ajo nuk mund te shtoje detyrimet e aksionere pervec operacioneve qe rredhin nga rigrupimi i aksioneve i kryer rregullisht.

Asambleja e pergjithshme e jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare vetem kur aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten 3/4 e aksioneve me te drejte vote. Per

mbledhjen e dyte, ky qorum eshte jo me pak se 1/2 e aksioneve me drejte vote.



Vendimet e asamblese se jashtezakonshme merren me shumicen prej 3/4 te votave qe u perkasin aksionereve te pranishern ose te perfaqesuar.

#### **Neni 41**

#### **Venia ne dispozicion te aksionereve te dokumenteve dhe informacioneve**

Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te aksionereve, ne kushtet dhe ne afatet e parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar jnga asambleja, dokumentet qe duhet t'u vihen ne dispozicion aksionereve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

### **KAPITULLI V**

#### **Kontrolloret e pavarur (Eksperti Kontabel i Autorizuar)**

#### **Neni 42**

#### **Emerimi dhe shperblimi**

Asambleja e pergjithshme e aksionereve, cakton nje kontrollor te pavarur dhe nje ndihmes te tij, te zgjedhur te dy nga listat e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.

Ne caktimin e kontrolloreve te pavarur mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara nga ligji nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare"

Kontrolloret e pavarur caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar.

Ata jane te ricaktueshem.

Shperblimi i kontrolloreve te pavarur caktohet nga asambleja aksionereve dhe perballohet nga shoqeria.



### **Neni 43**

#### **Detyrat dhe te drejtat**

Detyrat dhe te drejtat e kontrolloreve te pavarur te shoqerise jane ato te parashikuara nga ligji Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Asambleja e aksionereve mund t'u kerkoje kontrolloreve te pavarur kryerjen e kontrolleve apo verifikimeve te posacme per ceshtje me interes te shoqerise. Ekspertet kontabel te autorizuar thirren ne mbledhjen e drejtorise qe mbyll llogarite e vitit fhiancar te mbyllur si dhe ne te giitha asamblete e aksionereve. Me marrjen e raportit te eksperteve kontabel te autorizuar asambleja miraton raportin dhe bilancin e shoqerise. Raportet qe ata pergatitin depozitohen ne seline e shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

## **KAPITULLI VI**

### **LLOGARITE VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT**

#### **Neni 44**

##### **Viti financiar**


Shoqeria pergatit c'do vit financiar llogarite vjetore ne pajtimn me ligjin per kontabilitetin.

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

#### **Neni 45**

##### **Caktimi i rezultateve**

Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet ne pajtim me legjislacionin ne fuqi dhe mbas dhenies se raportit perfundimtar nga ekspertet kontabel te autorizuar.



## KAPITULLI VII

### PRISHJA, LIKUJDIMI, KUNDERSHTIMET

#### **Neni 46**

#### **Prishja, likuidimi**

Ne rastin e prishjes te shoqerise nje ose disa likuidatore emerohen nga Asambleja e pergjithshme e aksionereve ne kushtet e quorumit dhe me shumicen e parashikuar per asamblete e pergjithshme te zakonshme. Likuidatori perfaqeson shoqerine. Ai ka kompetenca te plota per te realizuar aktivin e shoqerise, te shlyeje kreditorët dhe te shpermdaje mbetjen e disponueshme.


Ndarja e aktivitetit neto qe mbetet pas rimbursimit te nominalitetit te aksioneve behet midis aksionereve ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre ne kapital.

#### **Neni 47**

#### **Zgjidhja e mosmarreshjeve**

Te gjitha mosmarreshjet gjate funksionimit te shoqerise ose gjat likuidimit te saj qe lindin midis shoqerise dhe aksionereve ose midis vete aksionereve, lldhur me vepnimtarine e shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

**KAPITULLI VIII**  
**EMERIMET E PARA**



**Neni 48**  
**Keshilli Mbikqyres**

Si anetare te keshillit te pare mbikqyres emerohen nga aksioneret themelues te Shoqerise "SALATI" Sh.a. per nje kohe prej tre vjetesh personat e meposhtem :

1. Gjergji Salati.
2. Luan Shehu.
3. Sokrat Dauti.

te cilet kane bere te ditur qe pranojne funksionet respektive dhe pohojne se nuk jane te prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre.

**Neni 49**  
**Ekspertet kontabel te autorizuar**

Emerohen si Eksperte Kontabel te Autorizuar te pare aksioneret per nje kohe prej 1 (nje) viti financiar:

1. Zoti Gezim Lila.
2. Zoti Namik Veipi,

te cilet kane bere te ditur qe pranojne funksionet e, tyre dhe pohojne se nuk jane te prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre.


**AKSIONERET THEMELUES**

**SOKOL SALATI**

Sokol Salati

**GJERGJI SALATI**

**LUAN SHEHU**




REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 623 Rep ; Nr. 135 Kol.

### VERTETIM

Sot me date 11. 02. 2000, para meje A. Robo, noter prane dhomes se noteris e Tirane, u parqiten personalisht shtetasi Sokol SALATI me nr. UG 405132 dhe shtetasit Gjergji SALATI e Luan SHEHU te dy te perfaqesuar me prokure te posacme nga shtetasi Sokol SALATI, te gjithë persona madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cilet me kerkuan nenshkrimin e aktit te mesiperm, i perpiluar prej tyre dhe jashte kesaj zyre dhe une noteri pasi e gjej te rregullt e veretoj ate rregullisht sipas ligjit.

NOTER

*Agim Robo*



PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

**KERKESE :**

**KERKUES :** Sokol SALATI. i biri i Tekiut dhe i Besies, i datelindjes 6 nentor 1962, lindur ne Vlore dhe banues ne Vlore, persom madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**OBJEKTI :** Rregjistrimin si persom juridik, te Shoqerise Tregtare "SALATI" Sh.a

**PERPARA GJYKATES SE RRETHIT**

**TIRANE.**

Ne mbashtetje te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne kriteret dhe mundesine qe vendosky ligj, per ushtrimin e aktivitetit si persom juridik.

Shoqeria Tregtare "SALATI" saja do te kete si objekt kryesor te veprimtrise se saj ate te tregtimit me shumice dhe pakice te naftes bruto, gazit dhe nenprodukteve te tyre. Gjithashtu kjo shoqeri do te ushtroje edhe aktivite ne fusha te tjera dhe konform objektit te saj te shprehur ne aktet e themelimit.

Shoqeria do te jete shoqeri anonime pa oferte publike dhe do te kete nje kapital fillestar prej 2.000. 000. leke. Ajo do te kete qendren e ushtrimit te veprimtrise se saj ne qytetin e Vlores ne adresen lagja "Rilindja" rruga "Petrit Bifsha" Vlore.

Aksioneret themelues te Shoqerise Tregtare "SALATI" Sh.a. do te jene zoterinjte Sokol Salati, Gjergji Salati dhe Luan Shehu. Kontributi i tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete ne menyre te barabarte dhe sejcili aksioner do te zoteroje nga 33.33.% te vleres te ketij kapitali.

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE




100  
LEKE  
RISHQIPERISE

PULLE TAKSE



100  
LEKE  
RISHQIPERISE







Shoqeria do te kete si antare te para te Keshillit Mbikqyres zoterinje Sokrat Dauti, Gjergji Salati dhe Luan Shehu. Drejtor i Shoqerise Tregtare "SALATI" Sh.a. do te jete aksioneri themelues Sokol Salati.

Per sa me siper meqenese kekrkesa jone gjendet plotesisht e bazuar ne kerkesat e ligji nr. 7638 date 19. 11. 1992 "Per Shoqerite Tregtare", kerkojme pranimin e saj sipas objektit.

**K E R K U E S**

**Sokol SALATI**

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**  
Nr. 694 Rep ; Nr. — Kol.

**V E R T E T I M**

Sot me date 15.02. 2000, para meje A. Robo, noter prane dhomes se noteris e Tirane, u parqiten personalisht shtetasi Sokol SALATI me nr. UG 405132 dhe shtetasit Gjergji SALATI e Luan SHEHU te dy te perfaqesuar me prokure te posacme nga shtetasi Sokol SALATI, te gjitha persona madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cilet me kerkuan nenshkrimin e aktit te mesiperem, i perpiluar prej tyre dhe jashte kesaj zyre dhe une noteri pasi e gjej te rregullt e veretoj ate rregullisht sipas ligjit.

**N O T E R**

*Agim Robo*



Republika e Shqiperise  
Ministria e Drejtesise  
Dhoma e Notereve Vlore



NOTERE DRITA AGA  
TEL 24715 VLORE  
GJYKATA FAKTIT

PROKUROR E POSACME

Vlore me daten 10/02/2000  
Nr 308 "epert"  
Kel. 326  
T.P. 150 + 2x50L.

Ne Vlore ditën e Hënjte date 10 SHKURT 2000 (dymije ) perpara  
meje DRITA TOPIK AGA - notere Publike me seli ne VLORE prane Gjyka  
tes se Faktit u paraqiten personalishte shtetasit Shqiptare :

1 -LUAN SHEHU i biri Bejazit dhe i Lelos lindur me 1962 dhe  
me banim ne Vlore ne lagjen " RILINDJA " madhor pa pengese ligjore  
re i njohur prej meje noteres -----

2- GJERGJI SALATI i biri Tekiut dhe i Besijes i vitit 1966 , madhor  
pa pengese ligjore i njohur prej meje noteres me banim ne Vlore  
ne lagjen " Lef Sallata " -----


Te paraqiturit ne baze te vullnetit te tyre dhe bazuar ne  
nenet 70 - 75 te KOSHQIPTAR ' Titulli i Perfaqsimit " kerkuan redakt  
min dhe legalizimin e nje Prokure te Posacme me objektin si me post  
te : -----

Autorizoj dhe Emeroj Perfaqses tonin te posacem shtetas  
Shqiptar : SOKOL TEKI SALATI i vitlindjes 1962 te cilit i japim te  
drejte qe ne emrin dhe per llogarine e te treve sikur te ishim te  
gjithe personalishte te neneshkruaje dokumentet themeltare te  
SHOQERISE ANONIME " SALATI : SHA me seli ne Vlore prane ORGANIT TE  
NOTERISE PUBLIKE si kerkesen , Aktin e Themelimit etj dhe ti paraqes  
ato ne Gjykate vete ose me ane te ndonje avokati per tu legjitimua  
si PERSON JURIDIK -----  
TE PERFAQSUARIT:

Gjergji Salati

Luan Shehu

Une notaria pasi peresitesit e gjeten prokuren e mesiperme kundre  
vullnetit te plotë te te treve dhe neneshkruan reg ullishte perpara meje  
konfirmoj vullnetin ne shoqerine treortakeshe duke vertetuar aktin ne  
tre kopje origjinaleme te njejeten vjare perdorimi .  
NO TERE





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**  
Nr. 622 Rep ; Nr. 134 Kol.

**VERTETIM**

Sot me date 11.02. 2000, para meje A. Robo, noter prane dhomes se noteris e Tirane, u parqiten personalisht shtetasi Sokol SALATI me nr. UG 405132 dhe shtetasit Gjergji SALATI e Luan SHEHU te dy te perfaqesuar me prokure te posacme nga shtetasi Sokol SALATI, te gjitha persona madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cilet me kerkuan nenshkrimin e aktit te mesiperm, i perpiluar prej tyre dhe jashte kesaj zyre dhe une noteri pasi e gjej te rregullt e veretoj ate rregullisht sipas ligjit.

**NOTER**

*Agim Robo*

